VENDIM
Nr. 230, datë 20.3.2013

PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE, DETYRAVE SPECIFIKE DHE STANDARDEVE TË SHËRBIMIT VETERINAR TË QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 54 të ligjit nr. 10 465, datë 29.1.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. FUNKSIONET, DETYRAT DHE STANDARDET E SHËRBIMIT VETERINAR TË PUSHTETIT VENDOR

1. Njësitë e qeverisjes vendore i ushtrojnë funksionet e tyre të shërbimit veterinar me anë të strukturave veterinare përkatëse, të cilat përbëhen nga mjekë veterinarë.

2. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për plotësimin me mjekë veterinarë të organikës së strukturave të tyre veterinare, në përputhje me kriteret e mëposhtme, përkatësisht, bashkitë dhe komunat me popullsi:

a) deri në 5 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 1 (një) mjek veterinar;

b) nga 5 000 - 10 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 2 (dy) mjekë veterinarë;

c) nga 10 000 - 20 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 3 (tre) mjekë veterinarë;

ç) nga 20 000 - 50 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 5 (pesë) mjekë veterinarë;

d) nga 50 000 - 100 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 6 (gjashtë) mjekë veterinarë;

dh) mbi 100 000 banorë, kanë në strukturat e tyre të shërbimit veterinar, të paktën 10 (dhjetë) mjekë veterinarë.

3. Strukturat veterinare të njësive të qeverisjes vendore kryejnë funksionet e mëposhtme:

a) bashkëpunojnë me strukturat e shërbimit veterinar rajonal për monitorimin dhe kontrollin e situatës epizotike në territorin në administrim të tyre;

b) përcaktojnë vendndodhjen e tregjeve të kafshëve të gjalla dhe kryejnë e administrojnë shërbimin veterinar pranë tyre;

c) kryejnë shërbimin veterinar në ambientet e therjes së kafshëve;

ç) përcaktojnë vendet për kullota dhe vendet e pirjes së ujit për kafshët;

d) mbajnë nën kontroll praninë e qenve dhe maceve endacake pa pronar në territorin e tyre;

dh) kontrollojnë shpërndarjen dhe funksionimin e njësive të shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zbukurimit;

e) organizojnë mbledhjen e kadavrave të kafshëve, si dhe përcaktojnë vendet e grumbullimit e të asgjësimit të tyre;

ë) marrin masa për rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të ujërave të zeza në territorin e tyre dhe ndalojnë hyrjen e kafshëve në to.

II. BASHKËPUNIMI I STRUKTURAVE VETERINARE NË NJËSINË E QEVERISJES VENDORE ME STRUKTURAT E SHËRBIMIT VETERINAR RAJONAL

1. Strukturat veterinare të njësisë së qeverisjes vendore bashkëpunojnë me strukturat e shërbimit veterinar rajonal dhe të drejtorive rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në qarqe për zbatimin e masave profilaktike, për kufizimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, si dhe për shkëmbimin e menjëhershëm të informacionit.

2. Në rast të konstatimit të një sëmundjeje infektive në territorin që mbulojnë, strukturat veterinare të njësisë së qeverisjes vendore e raportojnë menjëherë rastin pranë shërbimit veterinar të Drejtorisë Rajonale të

Bujqësisë dhe pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në qark. Formulari i raportimit miratohet me urdhër të ministrit.

3. Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit informon periodikisht, çdo muaj, strukturat veterinare të njësive të qeverisjes vendore për situatën epizootike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. PËRCAKTIMI I VENDNDODHJES DHE ADMINISTRIMI I TREGJEVE TË KAFSHËVE TË GJALLA

1. Njësitë e qeverisjes vendore përcaktojnë dhe bëjnë publike zonat e përshtatshme për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të kafshëve të gjalla në territorin që ata mbulojnë. Gjatë këtij përcaktimi duhet të ruhet distanca e përshtatshme e vendndodhjes së tregjeve nga qendrat e banuara në një largësi minimale prej 5 km nga vija e verdhë e këtyre qendrave, si dhe lidhja e përshtatshme e tyre me rrugët nacionale, me qëllim mënjanimin e pengesave në qarkullimin rrugor.

2. Njësitë e qeverisjes vendore verifikojnë dhe mbikëqyrin që tregjet të funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për fushën e veterinarisë, legjislacionit në fuqi për subjektet tregtare, si dhe të legjislacionit për licencimin e aktiviteteve.

3. Gjithashtu, njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave të tyre veterinare, verifikojnë dhe mbikëqyrin që këto tregje të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë nën kontrollin e përhershëm të një mjeku veterinar të strukturave veterinare të njësisë së qeverisjes vendore;

b) të jenë të pajisura me ambientet e përshtatshme për të garantuar kryerjen e rregullt të funksioneve të tij nga ana e mjekut veterinar të njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në treg;

c) ambientet e tregut të pastrohen dhe të dezinfektohen periodikisht përpara funksionimit të tyre, sipas udhëzimeve të mjekut veterinar të njësisë së qeverisjes vendore të pranishëm;

ç) ambientet e tregut të jenë të përshtatshme për kapacitetin e kafshëve që do të tregtohen;

d) tregu të jetë i pajisur me mjetet e nevojshme për ngarkimin, shkarkimin dhe mbajtjen e kafshëve brenda kushteve të mirëqenies, në lidhje me ushqimin, ujin, si dhe për çdo trajtim tjetër. Pajisjet dhe ambientet duhet të jenë të lehta për t'u pastruar dhe dezinfektuar;

dh) ambientet të jenë të pajisura me mjete dhe hapësira të përshtatshme për kontrollin shëndetësor veterinar;

e) ambientet të kenë hapësira të përshtatshme izolimi për kafshët;

ë) tregu të jetë i pajisur me mjete të përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e hapësirave për izolimin e kafshëve dhe të kamionëve;

f) tregu të ketë ambientet përkatëse dhe të përshtatshme për magazinimin e ushqimit, të mbeturinave dhe të plehut;

g) tregu të jetë i pajisur me një sistem të përshtatshëm për mbledhjen e ujërave të shkarkimit;

gj) asnjë ambient i vendit të grumbullimit të mos përdoret për therje;

h) në treg të tregtohen vetëm kafshë që janë të shoqëruara me certifikatë veterinare;

i) të gjitha kafshët që tregtohen në treg të jenë të identifikuara të paktën në nivel ferme.

4. Subjekti, i cili ka në administrim tregun e kafshëve të gjalla, dorëzon te mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, të pranishëm në treg, dokumentacionin e shoqërimit të kafshëve, numrat e identifikimit apo matrikujt e tyre.

5. Mjeku veterinar, bazuar në dokumentet e dorëzuara sipas pikës 4 të kreut III të këtij vendimi, regjistron në një regjistër apo në bazën elektronike të të dhënave, të miratuar nga autoriteti kompetent dhe mban për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet, të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e pronarit, origjinën, datën e hyrjes dhe të daljes, numrin e identifikimit të kafshës, numrin e regjistrimit të fermës së origjinës apo të tufës së origjinës;

b) numrin e regjistrimit të transportuesit dhe numrin e licencës së mjetit të transportit të përdorur për kafshët.

6. Kafshët që largohen nga tregu duhet të shoqërohen me një certifikatë lëvizjeje, të lëshuar nga mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në treg, sipas autorizimit të lëshuar për këtë rast nga autoriteti kompetent.

7. Tregu duhet të jetë plotësisht i boshatisur nga kafshët në fund të ditës dhe në gjendje për t'u pastruar dhe dezinfektuar tërësisht.

8. Duhet të ketë të paktën një ditë të plotë ndërmjet një tregu dhe tjetrit, gjatë së cilës mund të kryhet pastrimi dhe dezinfektimi.

9. Mjeku veterinar i pranishëm në treg nuk duhet të lejojë heqjen e matrikujve nga kafsha.

10. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për ndalimin e grumbullimit dhe të mbajtjes së kafshëve bujqësore në ambientet private të banuara, të cilat ndodhen në zona apo qendra urbane.

11. Në çdo rast, mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore në ambientet e tregut, kur konstaton shkelje të kushteve dhe standardeve të përcaktuara në këtë kre, njofton shërbimin veterinar rajonal për shkeljet e konstatuara dhe i kërkon marrjen e masave përkatëse në zbatim të legjislacionit në fuqi.

IV. KRYERJA E SHËRBIMIT VETERINAR NË AMBIENTET E THERJES SË KAFSHËVE

1. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë shërbimin veterinar në mjediset e therjes së kafshëve, duke bërë kontrollin mjekësor të kafshës para dhe pas therjes, vulosjen e karkasave të mishit, si dhe lëshimin e certifikatës veterinare, që shoqëron mishin e nënproduktet e tij. Vulosja dhe lëshimi i certifikatës bëhet vetëm nga mjeku veterinar.

2. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore siguron që procesi i therjes të kryhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi për kërkesat e higjienës së mishit dhe të nënprodukteve të tij.

3. Ambientet e therjes dhe aktiviteti i ushtruar në të janë nën kontrollin e përhershëm të një mjeku veterinar të njësisë së qeverisjes vendore, i cili ka në dispozicion një ambient përkatës të veçuar, brenda ambienteve të therjes, të pajisur me kushtet e përshtatshme për kryerjen e rregullt të funksioneve të tij. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore është i pranishëm në ambientet e therjes gjatë gjithë kohës dhe respekton orarin ditor të funksionimit të këtyre ambienteve.

4. Mjeku veterinar, i cili kryen shërbimin veterinar në mjediset e therjes së kafshëve, duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se tre vjet si mjek veterinar.

5. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientet e therjes, siguron që kafshët, të cilat mbërrijnë në ambientet e therjes të jenë të shoqëruara me certifikatën veterinare.

6. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientin e therjes, kontrollon klinikisht kafshët përpara procesit të therjes dhe lejon therjen e tyre. Kafshët, të cilat pas këtij kontrolli rezultojnë klinikisht jo të shëndosha, theren në vende të veçanta të ambientit të therjes.

7. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientin e therjes, kontrollon karkasat e mishit të kafshës së therur dhe e lejon për konsum publik, duke kryer vulosjen e tij.

8. Mishi i kafshëve të therura shoqërohet me certifikatën veterinare të lëshuar nga mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientet e therjes, me qëllim vendosjen e tij në treg.

9. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientet e therjes, mban regjistrin me të dhënat për të gjitha kafshët e therura, si dhe të produkteve që rrjedhin prej tyre, sipas tipit dhe modelit të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur.

10. Mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientet e therjes, siguron që transporti i mishit nga këto ambiente të bëhet me mjete, të cilat plotësojnë standardet sanitaro-veterinare të ruajtjes së mishit.

11. Në çdo rast, mjeku veterinar i njësisë së qeverisjes vendore, i pranishëm në ambientet e therjes, kur konstaton se këto ambiente nuk janë në përputhje me legjislacionin sanitaro-veterinar në fuqi, njofton menjëherë strukturën rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

V. PËRCAKTIMI I KULLOTAVE DHE I VENDEVE TË PIRJES SË UJIT NGA KAFSHËT

1. Njësitë e qeverisjes vendore bëjnë përcaktimin e kullotave dhe të vendeve të pirjes së ujit nga kafshët, në varësi të situatës epidemiologjike dhe, nëse është e nevojshme, marrin masa për ndalimin e përdorimit të tyre.

2. Njësitë e qeverisjes vendore bëjnë publike kullotat dhe vendet e pirjes së ujit nga kafshët, si dhe të çdo mase në lidhje me to.

VI. MBIKËQYRJA DHE MBAJTJA NËN KONTROLL E QENVE DHE MACEVE ENDACAKE PA PRONARË

1. Njësitë e qeverisjes vendore hartojnë programe pune të profilaksisë veterinare në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si dhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre.

2. Njësitë e qeverisjes vendore identifikojnë të gjithë qentë dhe macet e rrugës në territorin që ato administrojnë.

3. Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve e maceve të rrugës dhe grumbullimin e tyre në vende të posaçme, të miratuara nga autoritetet e qeverisjes vendore në zbatim të ligjit.

4. Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë transportin e maceve dhe të qenve të rrugës me mjete që respektojnë standardet e mirëqenies së tyre drejt vendeve të miratuara nga autoritetet e njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, këto mjete duhet të dezinfektohen me dezinfektantë të miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Njësitë e qeverisjes vendore kryejnë eliminimin e qenve dhe maceve të rrugës vetëm në rastet kur:

a) shfaqin shenja klinike të sëmundjeve infektive;

b) gjatë kontrollit për sëmundje zoonotike, kafsha paraqet rrezik për jetën e njeriut;

c) kafsha është treguar tepër agresive dhe e egër, si dhe ka sulmuar njerëzit.

6. Eliminimi i kafshëve për rastet e përmendura në pikën 5 të këtij kreu, kryhet me metodën e eutanazisë nga mjeku veterinar që ushtron praktikën mjekësore veterinare, duke përdorur një nga produktet mjekësore veterinare të miratuara.

7. Në të gjitha rastet kur ka braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës, njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për zbatimin e pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 10 465 dhe njoftojnë shërbimin veterinar rajonal për vendosjen e masave administrative.

8. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose kafshët e tjera.

9. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për të vendosur dhe për të zbatuar në territorin në administrim të tyre, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimit të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambiente publike.

VII. SHPËRNDARJA DHE FUNKSIONIMI I NJËSIVE TË SHITJES SË KAFSHËVE TË SHOQËRIMIT DHE TË ZBUKURIMIT

1. Njësitë e qeverisjes vendore përcaktojnë zonat në territorin e tyre për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së kafshëve të shoqërimit e të zbukurimit dhe i bëjnë publike ato.

2. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për monitorimin e shpërndarjes së njësive të tregtimit të kafshëve, në përputhje me pikën 1 të këtij kreu.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, nëpërmjet strukturave veterinare vendore, mbikëqyrin plotësimin e standardeve sanitaro-veterinare dhe të atyre të mirëqenies së kafshëve nga objektet e njësive të tregtimit të kafshëve të shoqërimit, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

4. Në rast të konstatimit të shkeljeve të përmendura në pikën 3 të këtij kreu, strukturat veterinare vendore njoftojnë menjëherë veterinerin zyrtar të shërbimit veterinar rajonal për subjektin shkelës, i cili, në bashkëpunim me këto struktura, merr masat administrative sipas legjislacionit përkatës.

VIII. ORGANIZIMI I MBLEDHJES SË KADAVRAVE TË KAFSHËVE DHE PËRCAKTIMI I VENDEVE TË GRUMBULLIMIT E ASGJËSIMIT TË TYRE

1. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me autoritetet mjedisore rajonale, përcaktojnë vendet e grumbullimit, eliminimit dhe groposjes apo të ndërtimit të krematoriumeve për kadavrat, si dhe i bëjnë publike ato.

2. Grumbullimi, eliminimi dhe groposja apo krematorizimi i kadavrave bëhet nga personel i kualifikuar dhe i trajnuar nga strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore.

3. Njësitë e qeverisjes vendore organizojnë struktura të posaçme për verifikimin në terren të kadavrave të pagroposura. Grumbullimi dhe transportimi i kadavrave bëhet në mjete transporti të përshtatshme, që sigurojnë moskontaminimin e mjedisit prej tyre.

4. Mjetet e transportit të kadavrave dezinfektohen pas çdo përdorimi me dezinfektantë të miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

IX. RRETHIMI DHE RUAJTJA E PIKAVE TË GRUMBULLIMIT TË UJËRAVE TË ZEZA DHE NDALIMI I HYRJES SË KAFSHËVE NË TO

1. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me autoritetet mjedisore rajonale, përcaktojnë vendet e grumbullimit të ujërave të zeza dhe sigurojnë rrethimin fizik të tyre me mjete solide e të pakalueshme, për të garantuar ndalimin e hyrjes së kafshëve në to.

2. Njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për pajisjen me sinjalistikën e nevojshme, të dallueshme dhe të qartë për publikun, të vendeve të grumbullimit të ujërave të zeza.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen njësitë e qeverisjes vendore të plotësojnë strukturat e tyre të shërbimit veterinar, në përputhje me përcaktimet në kreun I të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha